



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Kaçanikut (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Kaçanikut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit kishte realizuar pagesa në vlerë 458,448€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate.

A1 Pasurit jo kapitale në PVF ishin nënvlerësuar për vlerën 14,894€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Kaçanikut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A2 Në tri (3) raste është bërë pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.
- A3 Vonesa në realizimin e projekteve kapitale nga 207 deri në 524 ditë.
- A4 Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e 20% të pronave të paluajtshme. Të çdo viti fiskal.
- B2 Në tri (3) raste kemi mosrespektim të hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare.
- A5 Në tri (3) raste komuna kishte hyre në obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm.
- B3 Vonesa në pagesën e obligimeve financiare nga 30 deri në 81 ditë.
- B4 Në dy (2) raste kemi zhvillim të procedurave të prokurimit në mungesë të projektit ekzekutues.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Kaçanikut.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Kaçanikut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Kaçanikut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Kaçanikut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Kaçanikut.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi identifikuar fusha në të cilat nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Çështjet më me fokus dhe që kanë ndikuar në opinionin financiar të auditimit janë ato që kanë të bëjnë me klasifikimin jo të duhur të shpenzimeve.

Fusha për përmirësim të mëtejshëm janë identifikuar tek menaxhimi jo i mirëfilltë kontratave publike, hyrja në obligime kontraktuale në mungesë të buxhetit, mungesa e projektit ekzekutues, Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara, vonesa në pagesën e obligimeve financiare.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre gjashtë (6) janë rekomandime të reja, gjashtë (6) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbarrimore në vlerë 736,775€, nga kjo vlerë për kontratën kolektive ishin paguar 626,017€ ndërsa pjesa tjetër 110,758€ ishin për shkak të vonesave në pagesën e faturave që ka rezultuar nga mungesa e mjeteve.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

##### Gjetja

Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”. nenit 18 pikës 3 të Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Sipas gjetjeve të auditimit kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate, në vlerë prej 458,448€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarrimor/të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategoria investimet kapitale pagesa në vlerë 410,561€, mallra dhe shërbime në vlerë 22,122€, nga komunalit në vlerë 15,499€ dhe nga subvencionet dhe transfert pagesa në vlerë 10,266€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet.

##### Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate të shpenzimeve ndikojnë në

raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Mos regjistrimi i pasurive në regjistra kontabël**

**Gjetja** Sipas Rregullores Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore”, neni 6 përcakton se: pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

Në bazë të mostrave të testuar, në dy (2) raste në vlerë 14,894€ pasurit jo kapitale nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasurisë, si pajisje të teknologjisë informative në vlerë 5,150€ dhe kompresor me pajisje tjera në vlerë 9,744€.

Pasuri nën 1,000€ nuk janë regjistruar në e-pasuri nga mungesa e komunikimit të ndërsjellët i zyrtarëve përgjegjës.

**Ndikimi** Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë shkakton mungesë të informatave për menaxhmentin lidhur me pasurinë që ka në dispozicion komuna, shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të saktë dhe të plotë të informatave në PVF.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat kontabël sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A2 - Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit.

**Gjetja** Sipas Ligji i buxhetit Nr. 09/L-260 neni 9, pika 2 - Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas lëshimit të ndarjeve buxhetore të plota për vitin fiskal 2024, Qeveria dorëzon në Kuvend për informim tabelën që tregon ndryshimet e bëra në tabelën 4.2 (financimi i investimeve kapitale komunale), që kërkohet nga organizatat buxhetore për të përmbushur obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak.

Në baze të mostrave të testuar, kemi vërejtur se në tri (3) raste janë kryer pagesat nga fondet e projekteve të aprovuar në ligjin e buxhetit 2024 për projekt tjera.

- Kontrata për projektin "Ndërtimi i objekteve për banim social", është nënshkruar në vitin 2022 në vlerën prej 406,747€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2022/2023. Si rezultat i kësaj, në vitin 2024, komuna ka kryer pagesë për këtë projekt në vlerën prej 30,000€, duke shpenzuar fondet e projektit "Furnizimi me aparatura për QKMF-ën".
- Po ashtu, Komuna ka kryer pagesë për projektin "Ndërtimi i objekteve për banim social", në vlerën prej 30,000€, duke shpenzuar fondet e projektit "Blerja e veturës për kujdesin Paliativ".
- Kontrata për projektin "Hartimi i projekteve për Komunën e Kaçanikut" e nënshkruar në vitin 2023 në vlerë prej 120,000€, bazuar në ndarjet buxhetore të vitit. Megjithatë, projekti nuk ishte realizuar në tërësi gjatë vitit 2023. Si rezultat i kësaj, në vitin 2024 komuna ka kryer pagesë për këtë projekt në vlerë 25,106€ duke shpenzuar fondet e projektit "Ndërtimi i rrugëve dhe trotuarit Reshan".

Kjo ka ndodhur si rezultat i mos funksionimi të kontrolleve me rastin e përgatitjes, monitorimin dhe ekzekutimit të buxhetit për projekte kapitale.

**Ndikimi** Shfrytëzimi i fondeve nga një projekt për pagesën e obligimeve të projektit tjetër duke anashkaluar procedurat ligjore rritë rrezikun që projektet e aprovuara të mos realizohen dhe në mos arrijten e objektivave të komunës.

**Rekomandimi A2** Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale, duke i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja A3 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

**Gjetja** Sipas Rregullës Nr. 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23 menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Në bazë të mostrave të testuara në katër (4) raste kemi vërejtur se punimet

nuk ishin realizuar konform planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuara janë:

- Kontrata "Ndërtimi i Urës mbi Lumin Nerodime - Kaçanik" në vlerë 79,961€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 60 ditë.
- Kontrata "Ndërtimi i Nënkalimit - Kaçanik" në vlerë 210,097€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 70 ditë.
- Kontrata " Rregullimi i sheshit të qytetit" në vlerë 286,810€ nuk është kryer sipas planit të paraparë dinamik prej 24 muaj.
- Kontrata "Ndërtimi i trotuarit, shtegut për çiklizëm dhe ndriçimit publik në rrugë Murat Lika , Strazhë " në vlerë 122,852€ nuk është kryer sipas planit dinamik 90 ditë.

Vonesat për këto kontrata ishin nga 207 deri 524 ditë.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasoj e planifikimit jo të duhur të projektit dhe të disa problemeve në shpronësimin e pronave, si dhe vendosja e afateve për realizim të projekteve pa një analizë të duhur, si dhe mos përgjegjësia e operatorëve ekonomik në kryerjen e punimeve sipas afatit të paraparë me kontratë.

**Ndikimi** Vonesat në realizimin e projekteve ndikojnë në mos arritjen e objektivave të komunës, dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

**Rekomandimi A3** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigorozë në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Mos përmbushja e kërkesës ligjore për inspektimin e pronave të paluajtshme**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 06/L-005 Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 15 pika 1 dhe 2 e përcakton se: Inspektimi 1. Komuna inspekton pronat e paluajtshme brenda territorit të Komunës. Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese, 2. Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat.

Ne kemi vërejtur se komuna në vitin 2024 për tatimin në pronë të objekteve nuk kishte bërë asnjë inspektim (verifikimin) të pronave të paluajtshme, siç kërkohet nga ligji në fuqi. Komuna nuk ka ndërmarrë masa ose veprime alternative për verifikimin e 20% të pronave të paluajtshme/objekteve.

Sipas komunës shkak i mos kryerjes së inspektimeve të pronave dhe objekteve ishte mungesa e stafit,

**Ndikimi** Mos aplikimi i kërkesës ligjore për inspektim të pronës së paluajtshme rezulton në mungesë të informacionit të sakta mbi pronën e tatueshme. Kjo situatë mundëson rrjedhjen e gabimeve në vlerësim, duke mos reflektuar

gjendjen faktike në teren në krahasim me atë të evidentuar në Protax. Gjithashtu, kjo mungesë e informacionit mund të ndikojë në vlerësimin jo të saktë të të ardhurave për tatimin në pronë.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare**

**Gjetja** Sipas Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF - neni 22 Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 26 mostrat e testuara në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në tri (3) raste në vlerë 34,165.35€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimit/furnizimet pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja. Kjo shifër dhe numër është zvogëluar nga viti paraprak, por mbetet prapë për përmirësim.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

**Ndikimi** Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhërblerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A5 - Hyrja ne obligime kontraktuale pa buxhet dhe fonde të mjaftueshëm**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2024, neni 12 paragrafi 7 limitet në zotime dhe shpenzime. Nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga OB-të vetëm në raste se shpenzime e tilla për kosto totale të projektit janë të parapara në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2024 dhe për dy (2) vitet në vijim, Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale, planifikohen financimin e projekteve dhe shumën e ndarë që duhet të realizohen brenda tri (3) viteve.

Në bazë të mostrave të testuara kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

- Rregullimi i rrugës "Bob-Kulla e Hasanit" në vlerë 327,127€ kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt, për tri vite ishin ndarë fonde në vlerë

150,000€. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 171,172€ pa pasur buxhet të aprovuar.

- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU "Idriz Seferi" në vlerë 366,700€ kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt ishin ndarë fonde në vlerë 300,000€. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 66,000€ pa pasur buxhet të aprovuar.
- Ndërtimi i "objektit të zjarrfikëseve Kaçanik Faza II-të" në vlerë 143,516 kurse me Ligjin e buxhetit për këtë projekt ishin ndarë fonde në vlerë 50,000.00 €. Komuna ka hyre në obligime kontraktuale për 93,516€ pa pasur buxhet të aprovuar.

Kjo dukuri ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit pa pasur buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës dhe pa fonde të mjaftueshme.

#### **Ndikimi**

Hyrja në obligime pa planifikime buxhetore dhe pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara, apo implikime buxhetore për vitin aktual, si dhe ngarkesë për buxhetin e vitit vijues.

#### **Rekomandimi A5**

Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontrollet e nevojshme funksionojnë gjatë tërë kohës, në mënyrë që para inicimit të procedurave të prokurimit të sigurohet se projektet kapitale janë të përfshira në ligjin e ndarjeve buxhetore ka fonde të mjaftueshme buxhetore të ndara për të gjitha kontrata e lidhura.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave**

#### **Gjetja**

Sipas LMFPP-së Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 39 përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Në pesë (5) raste, faturat në vlerë totale prej 4,451€, për ndërtimi i fushës sportive në vlerë 1.555€, rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal në Komunën e Kaçanikut në vlerë 1.695€, mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike në vlerë në vlerë 516€, mirëmbajtje e objekteve dhe pajisjeve mjekësore në vlerë 500€ dhe paga për shërbime këshilluese në vlerë 185€ të paraqitura në RVF, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë, me vonesë nga 30 ditë deri në 81 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, mungesës së fondeve financiare për realizimin e pagesave brenda afatit ligjor.

#### **Ndikimi**

Si pasojë e vonesave në pagesën e faturave, komuna mund të përballet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat e shkaktuara të kërkuara nga palët e treta.

#### **Rekomandimi B3**

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e faturave, duke siguruar se pagesat bëhen brenda afatit të përcaktuar ligjor.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mungesa e projektit ekzekutues**

- Gjetja** Sipas Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik neni 19 specifikim teknik paragrafi 17 ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.
- Nga testimi jonë ka rezultuar se për dy (2) projekte kapitale nuk ishin përgatitur projektet ekzekutive, rastet kanë të bëjë me projektet:
- Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane - Kaçanik (Ritender) në vlerë 147,667€.
  - Ndërtimi i depos dhe garazhës në QKMF në vlerë 214,465€.
- Kjo ka ndodhur për shkak të neglizhencës së njërive kërkuese pa bërë paraprakisht hartimin e projekteve ekzekutive zbatuese dhe mos funksionimit efikas të kontrolleve tek zyra e prokurimit duke zhvilluar procedurat pa u përmbushur kërkesat ligjore.
- Ndikimi** Inicimi i procedurës së prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv, mund të ndikoj me realizim të dobët të kontratave për punë si dhe mund të afektojnë shpenzim të paparashikuar apo vlerë të dobët për paranë e shpenzuar.
- Rekomandimi B4** Kryetari duhet të sigurohet se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e projektit ekzekutiv sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,321,364€, prej tyre ishin shpenzuar 3,436,778€ apo 80%. Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, objektet arsimore, mirëmbajtje investive, ujësjellësve, kanalizimeve, pajisje etj.

#### Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit

**Gjetja** Sipas të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurimin publik neni 70.24 pika (f) parasheh se menaxherët e kontratës “Të sigurojnë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik.

Në bazë të mostrave të testuara, në katër (4) raste, menaxhimi i kontratave dhe vlerësimi i performancës së kontraktuesve nuk është mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (e-prokurimi), si:

- Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale - Kaçanik në vlerë 276.480€.
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në SHFMU “Idriz Seferi” në vlerë 367,000€.
- Ndërtimi i objektit për Zjarrfiksit- Kaçanik, Faza e dytë në vlerë 143.516€.
- Ndërtimi i kanalizimit fekal në fshatin “Begracë” në vlerë 295.121€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i kontrolleve të brendshme jo efektive në procesin e menaxhimit të kontratave përmes platformës elektronike të e-prokurimit.

**Ndikimi** Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfillt të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi e mjaftueshme që menaxhmenti apo përdoruesit e lejuar të marrin informata me kohë reale në lidhje me progresin dhe menaxhimin performancën e kontratave.

**Rekomandimi B5** Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në PVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 2,315,991€. Kjo vlerë përbehet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 2,042,630€, taksa nga ushtrimi i veprimtarisë 219,070€, taksat nga qiraja në vlerë 54,291€.

### Çështja B6 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Sipas Ligjit Nr.06/L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme neni 26 përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€.

Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2024, komuna ndërmori veprime për të mbledhur borxhet duke dërguar faturat/obligimet e paguara në përmbarim. Llogaritë e arkëtueshme në total, krahasuar me vitin e kaluar, janë rritur nga 1,973,138€, në 2,315,991€, duke shënuar një diferencë prej 342,853€, ose rreth 14.8%. Rritja ka të bëjë me tatimi mbi pronën.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efektive në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

#### Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal, vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

#### Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Po ashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.3.3 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e AB ka planifikuar pesë (5) Auditime te cilat i ka përfunduar të gjitha.

#### Çështja A6 - Mos funksionalizimi i NjAB-së

##### Gjetja

Sipas Ligji Nr. 06/I-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, neni 19 Themelimi i funksionit të auditimit të brendshëm paragrafi 2. Njësia e auditimit të brendshëm vendoset sipas njëres nga mënyrat si në vijim: 2.1. njësi e pavarur e auditimit të brendshëm në vartësi të drejtpërdrejtë të udhëheqësit të subjektit të sektorit publik; 2.2. njësi e përbashkët e auditimit të brendshëm sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave; 2.3. nëpërmjet një marrëveshjeje për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm nga një subjekt i sektorit publik tek një tjetër, me miratimin paraprak të Ministrit të Financave; apo 2.4. nëpërmjet kontraktimit të një kompanie profesionale për kryerjen e auditimit të brendshëm, pas aprovimit të Ministrisë së Financave.

Udhëheqësja e NjAB-se me datën 21.03.2025 kishte dalë në pension dhe komuna nuk kishte ndërmarr masa në funksionalizimin e NjAB-së.

Shkak i është se penzionimi i udhëheqësit të NjAB-se dhe menaxhmenti nuk ka treguar përgjegjësi të duhur për angazhimin e auditorit të brendshëm / udhëheqësit të NjAB të rëndësishme në monitorimin e funksionimit të kontrolleve të brendshme..

##### Ndikimi

Mos funksionalizimi i NjAB-së ndikon në efektivitetin e sistemit të kontrolleve të brendshme, dhe mungesës së monitorimit të mbarëvajtjes së aktiviteteve të punës në komunë.

##### Rekomandimi A6

Komuna duhet të sigurojë që NjAB te mos mbetet pa udhëheqës se NjAB-se dhe të ndërmarr masa në angazhimin e një udhëheqës se NjAB-se.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

| Përshkrimi                   | Buxheti fillestar | Buxheti final <sup>5</sup> | 2024 Shpenzimet   | 2023 Shpenzimet   | 2022 Shpenzimet  |
|------------------------------|-------------------|----------------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| <b>Burimet e fondeve</b>     | <b>11,958,982</b> | <b>13,147,496</b>          | <b>12,132,927</b> | <b>11,159,685</b> | <b>8,975,661</b> |
| Grante Qeveritare - Buxheti  | 11,034,782        | 10,832,821                 | 10,831,509        | 10,345,461        | 8,111,286        |
| Financimi përmes huamarrjes  | 0                 | 0                          | 0                 | 0                 | 73,968           |
| Të bartura nga viti i kaluar | 0                 | 1,098,068                  | 688,195           | 440,514           | 386,278          |
| Të hyrat vetanake            | 924,200           | 924,200                    | 357,502           | 368,928           | 395,449          |
| Donacionet vendore           | 0                 | 5,678                      | 3,116             | 4,781             | 8,680            |
| Donacionet e jashtme         | 0                 | 286,729                    | 252,604           | 0                 | 0                |

Komuna për vitin 2024 kishte realizuar pagesa në vlerë 12,132,927€ apo 92% e buxhetit final. Buxheti final ishte më i lartë se buxheti fillestar për 1,188,514€. Kjo rritje ishte nga bartja e të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,098,068 € dhe donacionet prej 292,408€, po ashtu kemi zvogëlim të buxhetit në shumë prej 201,961€ me vendim të qeverisë.

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

| Përshkrimi                                             | Buxheti fillestar | Buxheti final     | 2024 Shpenzimet   | 2023 Shpenzimet   | 2022 Shpenzimet  |
|--------------------------------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| <b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b> | <b>11,958,982</b> | <b>13,147,496</b> | <b>12,132,927</b> | <b>11,159,685</b> | <b>8,975,661</b> |
| Pagat dhe mëditjet                                     | 6,759,179         | 6,557,218         | 6,557,218         | 6,157,975         | 5,069,788        |
| Mallrat dhe shërbimet                                  | 1,421,513         | 1,458,206         | 1,430,944         | 1,540,810         | 969,418          |
| Komunalitë                                             | 200,000           | 252,246           | 200,562           | 147,744           | 176,626          |
| Subvencionet dhe transferet                            | 415,529           | 558,463           | 507,425           | 360,285           | 322,604          |
| Investimet Kapitale                                    | 3,137,761         | 4,321,364         | 3,436,778         | 2,952,871         | 2,437,225        |
| Rezervat                                               | 25,000            | 0                 | 0                 | 0                 | 0                |

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 201,961€. Zvogëlimi ishte nga Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 03/239 i datës 24.12.2024.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 36,693€ nga kjo vlerë:34,293€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 2,400€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime komunale krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 52,246€ nga të hyrat vetjake të bartura nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 142,934€ nga kjo vlerë:139,803€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 dhe 3,131€ rritje nga donacionet.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,183,603€ nga kjo vlerë: 871,727€ rritja nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023,dhe 286,876€ rritje nga donacionet, po ashtu nga rezerva rritja është 25,000€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se nga kjo kategori thesari dhe komuna sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishin paguar 511,158€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive dhe obligime të tjera ndaj operatorve ekonomik.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 2,315,991€. Kjo vlerë përbëhet nga llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë në vlerë 2,042,630€, taksat nga qiraja në vlerë 54,291€ dhe të hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë vlerë 219,070€.

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024 ishin 924,200€, përderisa ishin realizuar 743,936€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Arsye e mos përmbushjes së planit të të hyrave ishte realizimi i ulët i të hyrave nga tatimi në pronë, nga i cili ishin planifikuar 427,088€ dhe ishin realizuar vetëm 310,632€, apo 66%

Të hyrat e grumbulluara nga institucionet nga niveli qendror që u shpërndahen komunave për vitin 2024 janë Gjjobat nga trafiku në shumën prej 197,207€, Gjjobat nga Gjykatat në shumën prej 12,850€ dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në shumën prej 26,968€ (këto të hyra nuk janë të përfshira në planin buxhetor të komunës).


Tabela 3. Të hyrat (në €)

| Përshkrimi                | Buxheti fillestar | Buxheti final  | 2024 Pranimet  | 2023 Pranimet  | 2022 Pranimet  |
|---------------------------|-------------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| <b>Totali i të hyrave</b> | <b>924,200</b>    | <b>924,200</b> | <b>743,843</b> | <b>884,219</b> | <b>682,981</b> |
| Të hyrat tatimore         | 472,088           | 472,088        | 310,633        | 443,998        | 380,303        |
| Të hyrat jo tatimore      | 452,112           | 452,112        | 432,959        | 440,162        | 302,678        |
| Të hyrat tjera            | 0                 | 0              | 252            | 59             |                |

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për RFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me 14 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tetë (8) rekomandime janë zbatuar, dhe gjashtë (6) rekomandime nuk janë adresuar siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

| Nr | Fusha e Auditimit   | Rekomandimet e vitit 2023                                                                                                                                                                                                                                                          | Veprimet e ndërmarra                     | Statusi                 |
|----|---------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|-------------------------|
| 1. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 2. | Baza për konkluzion | Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.                          | Vonesa në pagesën e faturave             | Nuk ka filluar zbatimin |

|     |                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                          |                         |
|-----|--------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|-------------------------|
| 3.  | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar se angazhimi i stafit për punë jashtë orari të rregullt do të bëhet vetë pasi që është bërë një planifikim dhe një analizë e mirëfilltë për nevojat si në rastet e jashtëzakonshme a po kur të rritet vëllimi i punës dhe autorizohet paraprakisht nga Kryetari i Komunës. Në rastet kur ka nevojë që stafi të angazhohet jashtë orarit të rregullt puna e tyre mos ta tejkalo 8 orë në javë . | Rekomandim i zgjidhur.                   | I zbatuar               |
| 4.  | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të ndërmerr veprime për ta rregulluar pozitën e kryeinfermierit në QKMF në pajtim me organogramin e drejtorisë së shëndetësisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Rekomandim i zgjidhur.                   | I zbatuar               |
| 5.  | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të shtoj kontrollet ndaj zyrës së prokurimit dhe në rastet kur OE tërhiqen gjatë procesit të tenderimit të bëhet konfiskimi i sigurisë së tenderit.                                                                                                                                                                                                                                                                                | Rekomandimi i zgjidhur.                  | I zbatuar               |
| 6.  | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që përmes menaxherit të kontratës do të bëhet mbikëqyrje e mirëfilltë e kontratave dhe pagesat mos të bëhet pa u siguruar se kontrata po zbatohet në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre.                                                                                                                                                                                                  | Rekomandimi i zgjidhur.                  | I zbatuar               |
| 7.  | Baza për konkluzion                  | Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe parallogarinë e dosjes specifikohet brendi.                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Rekomandimi i zgjidhur.                  | I zbatuar               |
| 8.  | Të hyrat                             | Kryetari duhet të sigurojë se paratë e grumbulluara nga lëshimi i çertifikatave do të dorëzohen me kohë tek arkëtari në mënyrë që parat të deponohen në bankë në llogarinë e komunës në fund të ditës.                                                                                                                                                                                                                                            | Rekomandimi i zgjidhur.                  | I zbatuar               |
| 9.  | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.                                                                                                                                                                                                  | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 10. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.                                                                                                                                                                                                                                                                  | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme. | Nuk ka filluar zbatimin |
| 11. | Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë | Kryetari duhet të shtoj kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.                                                                                                                                                                                                                                                                              | Rekomandimi i zgjidhur.                  | I zbatuar               |

|     |                         |                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                        |                        |
|-----|-------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|------------------------|
| 12. | Investimet kapitale     | Kryetari të sigurojë kontrole dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara. | Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.                               | Nuk ka filluar zbatimi |
| 13. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.                                   | Kishte rritje të llogarive të arkëtueshme sidomos tek tatimi në pronë. | Nuk ka filluar zbatimi |
| 14. | Llogaritë e arkëtueshme | Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët që merren me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme do të azhurnojë dhe mbajnë regjistra të saktë të llogarive të arkëtueshme.                                                                                         | Rekomandimi i zgjidhur.                                                | I zbatuar              |


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit




Fanol Hodolli, Udhëheqës i ekipit



Agim Sogojeva, Anëtar i ekipit



Shefkije Beka, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

|                                                                                   |                    |            |                                                                                  |         |         |                                                                                   |                                                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------|--------------------|------------|----------------------------------------------------------------------------------|---------|---------|-----------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
|  |                    |            | REPUBLIKA E KOSOVES<br>REPUBLIKA KOSOVA<br>KOMUNA E KAÇANIKUT<br>OPŠTINA KAÇANIK |         |         |  |  |
| 1                                                                                 | Data               | 29.05.2025 | Vendi                                                                            | Kaçanik |         |                                                                                   |                                                                                   |
|                                                                                   | Nj. org.           |            | Numri                                                                            |         | Shtojcë |                                                                                   |                                                                                   |
|                                                                                   | 01-400/01-12058/25 |            |                                                                                  |         |         |                                                                                   |                                                                                   |

**Komuna e Kaçanikut**

Opština Kaçanik/ Municipality of Kaçanik

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Kaçanikut, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Besim Ilazi- Kryetar i Komunës së Kaçanikut

Data: 29 maj 2025, Kaçanik



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.